

RAPORTI

I VLERËSIMIT TË JASHTËM


Për Programin e studimit

BSC. në Inxhinieri Elektrike

Universiteti Privat Albanian University

Eksperti i vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asc. Dr. Aida Spahiu



(Qershor/2016)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc në Inxhinieri Elektrike

	Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:	
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr. 479, date 10.10.2012
3.1	Riorganizimi	Urdhër 52 datë 05.02.2016
4	Titulli i programit të studimit:	Inxhinieri Elektrike
5	Cikli i studimit:	Bachelor
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	180
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
15	Aktivizimi i programit të studimit	2013 - 2014
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2014 - 2015
	etj	

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim



HYRJE

Albanian University është një institucion privat, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë. Ky institucion është licencuar në Prill të vitit 2004, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

Programi i studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike, filiali i Tiranës, është hapur nga ky Institucion në vitin akademik 2014-2015, me të tre vitet e bachelor. Për herë të parë në vitin 2014-2015 janë regjistruar 16 studentë dhe 33 studentë në vitin akademik 2015-2016, Gjashtë studentet e parë janë diplomuar në vitin akademik 2014-2015.

Ky program studimi zhvillohet në ambientet e ndërtesës së Albanian University në Rrugën e Kavajës, Tiranë.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

KA dhe APAAL vendosën Prof. Asc. Dr. Aida Spahiu si eksperte të jashtëme për këtë program studimi. GVJ është asistuar nga specialistja e APAAL Znj. Juna Mengri.

GVJ pasi u njoh me këto komente e bëra nga institucioni mori parasysh të mos paraqes në raport sygjërimin në lidhje me ponderimin e provimeve.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit


Pjesa përshkimore

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, i hapur në Tiranë, ka për qëllim të krijojë një profil të mirë të studentit të diplomuar, i cili do të jetë i aftë që nëpërmjet procesit të përfitimit të njohurive dhe vlerësimit, të zhvillojë një sërë shprehish dhe kompetencash, si:

- a) aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë në firma të ndryshme ku ka sisteme elektrike të fuqisë dhe të industrisë, të automatikës, etj.;
- b) aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë drejtpërdrejt në industrinë e prodhimit të pajisjeve elektrike apo të projektimit dhe realizimit të tyre;
- c) pas një periudhe stazhi në profesion, aftësinë për të drejtuar kualifikimin apo edhe përgatitjen e teknikëve dhe kuadrove të ardhshëm në këto fusha.

Ky program studimi trevjeçar u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfutur kompetenca më specifike gjatë studimeve të specializuara në programet e ciklit të dytë.

Mundësitë e punësimit për të diplomuarit në këtë program studimi paraqiten si më poshtë:



- Në ndërmarrje, korporata dhe laboratorë ku ka aparatura elektrike të sistemeve elektrike të fuqisë, të industrisë, ente tregtare të ndryshme që kanë pajisje elektrike, si në industri, shëndetësi etj;
- Në firma të ndryshme private të pajisura me sisteme elektrike dhe elektronike;
- Në kurse të ndryshme profesionale për përgatitjen e teknikëve elektrik etj.

Procesi mësimor dhe kërkimi shkencor në Albanian University synon rritjen e cilësisë së mësimdhënies në mënyrë që tu jap studentëve aftësi metodologjike për kërkim si dhe përpiqet të sigurojë integrimin e mësimin me punën kërkimore.

Albanian University bën përpjekje në plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, kualifikimin e personelit akademik, si dhe krijon ambiente laboratorike për zhvillimin dhe punën në institucion, etj.

Albanian University me anë marrëveshjeve me kompani të ndryshme mundëson realizimin e praktikave profesionale për studentët si dhe kryen veprimtari të tjera në përputhje me statutin e Albanian University, sipas objektivave specifike të institucionit në këtë drejtim.

Në kuadër të zhvillimit të kurrikulave, për programet që mbështet Departamenti i Inxhinierive, bëhen përpjekje për një përditësimi të vazhdueshëm të njohurive të marra në këto programe studimi.


Departamenti parashikon, si strategji afatmesme hapjen e programit Master i Shkencave/Master Profesional në Inxhinieri Elektrike, pasi në vitin akademik 2014-2015 janë diplomuar studentët e parë, në Bachelor në Inxhinieri Elektrike në Tiranë.

Ndërsa si strategji afatgjatë parashikohet hapja e programeve Doktoraturë në fushat që mbulon departamenti i inxhinierive.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>K3. Programi i studimit është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, dhe në përputhje me qëllimet dhe misionin e Albanian University.</p> <p>K4. Programi i studimit i ka të përcaktuar qartë objektivat për formimin e studentëve në këtë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit</p> <p>K5. Programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik, duke patur parasysh që në Shqipëri ka ndërmarrje të vogla dhe të mesme, të cilat kanë nevojë për një student me diplomë bachelor në Inxhinieri Elektrike.</p> <p>K6. Programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.



Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>K1. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike është përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit dhe te njesise kryesore.</p> <p>K2. Programi bachelor në Inxhinieri Elektrike synon pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>K3. Ky program i formon studentet dhe me shprehi të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; Numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>K1. Programi i studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike synon të plotësoj nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>K2. Institucioni nuk kishte bërë një vlerësim të plotë të nevojave të tregut të punës, për qytetin e Tiranës ku është hapur ky program studimi.</p> <p>Pra nuk ishte informacioni i nevojshëm në lidhje me:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe intereseve kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>K1. dhe K2. Ky program studimi është në përputhje të plotë me interesat kombëtare dhe synon të ruaj vlerat kulturore kombëtare.</p>
Konkluzione të GVJ:	
<p>Programi i studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike, i hapur në qytetin e Tiranës, i plotëson më së miri të gjitha kriteret e standarteve I.1, I.2. Programi i studimit është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, dhe në përputhje me qëllimet dhe misionin e Albanian University.</p> <p>Për të patur një informim më të mirë të studentëve programi i studimit duhet të jetë i vendosur dhe në faqen e Universitetit www.albanianuniversity.al. Në këtë faqe gjendet vetëm kurrikula e programit të studimit, si listë lëndësh. http://www.albanianuniversity.al/al/programe-studimi.</p> <p>Institucioni duhet të kryej një studim të tregut të punës, kërkesat e punëdhënësve sidomos për pjesën qëndrore të vendit, të bëj një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve dhe të ketë informacion në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në programet bachelor në Inxhinieri Elektrike të ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të Lartë në vendin tonë. Në këtë mënyrë Institucioni do të ketë ide të qarta në lidhje me numrin e studentëve që i nevojiten tregut të punës në terma afatmesme dhe afatgjatë, cilësinë e tyre, orientimin e mësimdhënies në funksion të drejtimit të kërkuar më shumë nga tregu si inxhinieri bachelor industrial apo i sistemeve energjitike. Si dhe do të jenë më të qarta objektivat afatmesme dhe afatgjata që Institucioni i ka vënë vetes.</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë

Pjesa përshkrimore

Mbështetur në RVB dhe organigramën e Albanian University, material në dosjen e akreditimit DA, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është njësi kryesore e Albanian University që organizon dhe drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Fakulteti ofron programe të studimeve të ciklit të parë bachelor në: Inxhinieri Elektrike, Elektronike, Mekatronike, Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni, programe të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike, Mekatronike, Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni, në përfundim të të cilave përfitohet diplomë sipas ciklit përkatës.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore - shkencore dhe nga administrata. Autoritetet drejtuese janë dekani dhe përgjegjësit e departamenteve ndërsa organ drejtuese është Këshilli i Fakultetit. Aparati administrativ i Fakultetit përbëhet nga Sekretaria mësimore dhe nga personeli ndihmës.

Struktura organizative, përbërja, funksionimi dhe të tjera çështje që lidhen me të përcaktohen në rregulloren e fakultetit.

Këshilli i Fakultetit është organ drejtues kolegjal vendimmarrës i cili drejtohet nga Dekani. Këshilli i fakultetit ushtron kompetencat si vijon:

- Programon e përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale të fakultetit.
- Propozon programe të reja studimi ose kërkimi shkencor, hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh apo njësisish të tjera,
- Shqyrton dhe miraton raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore dhe kërkimin shkencor.
- Këshilli i Fakultetit i propozon Senatit Akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyr realizimin e tij.

Këshilli i fakultetit përbëhet nga dekani, personeli akademik efektiv, kancelari i fakultetit, si dhe nga një student përfaqësues për çdo program studimi, që mbështet fakulteti. Mandati i Këshillit të Fakultetit është 4 vjeçar. Mënyra e funksionimit të Këshillit të Fakultetit dhe çështje të tjera organizative dhe vendimmarrëse përcaktohen në rregulloren e fakultetit, neni 9 dhe 10.

Dekani është funksionari më i lartë drejtues dhe përfaqësues i Fakultetit. Ai koordinon, organizon, drejton, kontrollon dhe përgjigjet për ecurinë e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor në fakultet. Dekani emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga Administratori i Universitetit me propozimin e Senatit akademik për një mandat 4 vjeçar me të drejtë riemërimi. Dekani i Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka titullin "Profesor i asociuar" në përputhje me ligjin e Arsimit të lartë Nr. 80/2015.

Dekani i Fakultetit drejton, kontrollon, organizon dhe përgjigjet për ecurinë e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor në Fakultet.

Dekani është funksionari llogaridhënës që përfaqëson Fakultetin pranë Senatit Akademik dhe Bordit Administrativ.

Dekani mban përgjegjësi direkt lidhur me veprimtaritë si vijon:

- Aktivitetin mësimor dhe kërkimor të Fakultetit,
- Organizimin e eventeve shkencore dhe promovuese,

- Administrimin e rregullt të dokumentacionit akademik dhe mësimor,
- Zbatimin e programit vjetor të Fakultetit,
- Disiplininin e punës nga ana e personelit akademik dhe jo akademik,
- Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së veprimtarisë së Fakultetit,
- Çështje të tjera të Fakultetit të lidhur me procesin e akreditimit.

Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit: Përbëhet nga departamentet:

- Departamenti i Inxhinierive
- Departamenti i Arkitekturës
- Departamenti i Shkencave Ekonomike

Departamenti i Inxhinierive është njësi bazë mësimore-shkencore në Fakultetin Fakulteti i Shkencave të Aplikuar dhe Ekonomike. Departamenti ka për detyrë të nxisë, të bashkërendojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit.

Përgjegjësi i Departamentit të Inxhinierive ka titullin “Profesor i asociuar” në përputhje me ligjin e Arsimit të lartë Nr. 80/2015. Ai është funksionari më i lartë drejtues i njësisë, i cili drejton, organizon, koordinon dhe përgjigjet për punën mësimore dhe kërkimore shkencore në njësinë bazë dhe i raporton dekanit. Përgjegjësi i departamentit propozohet nga Senati akademik dhe emërohet nga Administratori me një mandat 4 vjeçar me të drejtë riemërimi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Gjatë vizitës në Departamentin e Inxhinierive u konstatua se ndryshe nga sa jepet në RVB nuk ka qendër të kërkimit shkencor në organizimin e fakultetit. Në lidhje me këtë çështje u pyetën në takimin përmblyës dhe titullarët e Universitetit dhe Fakultetit, dhe shpjegimi që u dha ishte se qendra kërkimore – shkencore ishte shkruar si rezultat i riorganizimit të ri të Institucionit. Mendoj se qendra kërkimore shkencore nxit dhe mbështet punën kërkimore të stafit të brendshëm të këtij fakulteti, që është një nevojë e domosdoshme për këtë fakultet. I gjithë organizimi tjetër ishte në përputhje me organigramën e dhënë në DA.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Mbështetur në raportin e vlerësimit të brendshëm, bisedat me grupin e vlerësimit të brendshëm, përgjegjësin e Departamentit të Inxhinierive dhe me punonjësen e burimeve njerëzore konstatuam se për vitin akademik 2015-2016, programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike në Tiranë vërejmë:

- Departamenti i Inxhinierive ka 19 Personel Akademik Efektiv (PAE), ku vetëm 4 PAE janë me grada dhe tituj ndësa 15 Personel Akademik Efektiv (PAE) janë me diplomë Master, <http://ëëë.albanianuniversity.al/al/universiteti/stafi-pedagogjik>
- Raporti Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) për Departamentin e Inxhinierive, viti akademik 2015 – 2016, është 19/27, ku peshën kryesore të mësimdhënies e mbajnë PAK, të cilët janë dhe pjesa më e kualifikuar dhe titullarë në më shumë se 2/3 e lëndëve që zhvillohen në këtë program studimi të ciklit të parë.
- Raporti Personel akademik/Personel administrativ/student, për vitin akademik 2015 – 2016 është 46/7/70. Ajo që bie në sy dhe nga RVB është se ndërsa numri i studentëve është rritur krahasuar me vitin akademik 2014-2015 numri i stafit akademik është zvogëluar. Ky raport për vitin akademik 2014 – 2015 ka qenë 67/7/44.

- Raporti PAE/PAK që mbështet programin e studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike për vitin akademik 2015 – 2016 është 15/16, për filialin e Tiranës.

Në fillim të vitit akademik, bazuar në nevojat e tyre për personel akademik, njësitë bazë të Fakultetit përkatës i paraqesin Këshillit të Fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante. Këshilli i Fakultetit përcakton kriteret e pranimit, procedurat e konkurrimit dhe krijon Komisionin e vlerësimit.

Komisioni i vlerësimit përbëhet si vijon:

- Përgjegjësi i njësisë bazë i cili kryeson Komisionin;
- Dy anëtarë të personelit akademik, me eksperiencë të gjatë mësimdhënie, të propozuar nga Përgjegjësi i njësisë bazë;
- Një përfaqësues i zyrës së kurrikulave, i propozuar nga Drejtuesi i zyrës së zhvillimit të kurrikulave.

Kandidatët marrin pjesë në konkursin publik sipas procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Fakultetit dhe të shpallura nga Fakulteti.

Komisioni i vlerësimit pasi shqyrton kandidaturat i propozon Dekanit për miratim kandidatët e përzgjedhur, ku përparësi i jepet kandidatëve që plotësojnë më mirë kriteret dhe i përgjigjen përshkrimit të vendit të punës.

Pasi struktura përkatëse e Universitetit ka shpallur kandidatin fitues nga përzgjedhja, kandidati fitues nënshkruan kontratën e punës me të drejtë ripërsëritjeje, e cila nënshkruhet nga Administratori dhe i punësuari. Pas kalimit të kohës së provës, pedagogët mund të punësohen me kontrata me afat të caktuar, jo më shumë se një vit, me të drejtë përsëritjeje.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Gjendja e konstatuar në Institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues nuk ka ndryshime. (tabela 1 dhe 2 në Aneksin 1 bashkangjitur këtij Raporti).

Gjendja e konstatuar në Institucion në Raport me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues nuk ka ndryshime (tabela 3 në Aneksin 3 bashkangjitur këtij Raporti) .

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Aneksi 3)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>K1. Nga vizita e kryer në zyrën e burimeve njerëzore të Universitetit dhe nga kontaktet e kryera me stafin akademik të brendshëm dhe përgjegjësin e Departamentit të Inxhinierive konstatuam se institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente duke bërë njoftim për vendim bosh në UTV Neës, stacion televiziv i Universitetit dhe në faqen e fakultetit, pasi Departamentet sjellin kërkesat e tyre. Më tej ngrihet një komision vlerësimi nga Dekani i Fakultetit dhe përgjegjësi i departamentit për të vlerësuar</p>

	<p>kandidaturat e paraqitura.</p> <p>K2. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, që mbështet këtë program studimi, për vitin akademik 2015-2016, dega e Tiranës përbën 48.38% të të personelit akademik të angazhuar. Pjesa tjetër është personel PAK dhe është pjesa më e kualifikuar e personelit për këtë program studimi.</p> <p>K3. Institucioni e kryen vlerësimin e personelit me anë të formularëve të vlerësimit që u jepen studentëve në fund të çdo semestri, rezultatet e këtyre formularëve paraqiten në një raport nga përgjegjësi Departamentit. Gjatë vizitës në Institucion pyetëm specialisten e zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë si veprohej me tej pasi merrej raporti nga përgjegjësi i departamentit por nuk patëm një përgjigje mbi vazhdimin e procesit. Kjo procedurë e ndjekur është procedurë transparente e vlerësimit të personelit.</p> <p>K4. Institucioni mban një bazë të dhënash të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë.</p>
<p>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor", ose titullin akademik "Docent".</p>	<p>K1. Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, këtë e konstatuam gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore ku pamë në mënyrë rastësore dosjet e kater anëtarëve të stafit akademik, të cilat ishin të plota me kontratat semestrale, CV, diplomat e tyre etj.</p> <p>K2. Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ</p> <p>K3. Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e stafit publikohen në UTV Neës dhe ne faqen e universitetit.</p> <p>K4. Institucioni ka angazhuar titullar lëndësh, që kanë së paku gradën doktor, ato kanë hartuar kurrikulën e lëndës, lektorë janë personel tjetër që në shumicën e lëndëve kanë së paku gradën "Doktor", por ka lëndë që jepen nga personel me titull Msc. Ajo që vlen për të theksuar është një që shumica e titullarëve të lëndëve është nga personeli PAK, pasi kjo është dhe pjesa më e kualifikuar e stafit për këtë program studimi, mbështetur në programet e lëndëve të vendosura në faqen e apaal.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktur për 12 studentë).</p>	<p>K1. Institucioni ka 7 anëtare në personelin ndihmës mësimor shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore, që është numër i mjaftueshëm për numrin 71 studentë në tre vite që ka ky program studimi, dega Tiranë.</p> <p>K2. Institucioni nuk e plotëson si duhet kriterin 2, pasi personeli akademik i angazhuar është kryesisht personel akademik me kontratë, të cilët janë dhe</p>

Spalun

	<p>titullarët e lëndëve.</p> <p>K3. Gjatë vizitës në Institucion na u vunë në dispozicion kontratat e lidhura me disa biznese për kryerjen e praktikës mësimore. Duke patur parasysh numrin e ulët të studentëve në vitin e tretë 17 studentë, mendojmë që ka personel mjaftueshëm për mbikëqyrjen e praktikës profesionale.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>K1. Institucioni nuk organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p> <p>K2. Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara, të cilën e pamë në sekretari.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të stafit, bën vlerësimin transparent të tij nëpërmjet formularëve të vlerësimit.</p> <p>Institucioni nuk plotëson Kriterin 2 të standartit III.1 pasi personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, që mbështet këtë program studimi, për vitin akademik 2015-2016, filiali Tiranë, përbën 48.38% të personelit akademik të angazhuar dhe jo 70%. Ky personel efektiv ka kualifikim të ulët krahasuar me atë PAK, 79% ka diplomë Master.</p> <p>Institucioni disponon bazë të dhënash për personelin e tij PAE dhe PAK por ai duhet të bëjë më shumë përpjekje për plotësimin siç duhet të kriterit 4 të standartit III.2 pasi shumicën e titullarëve të lëndëve, të cilët janë me gradën "Doktor" dhe tituj akademik janë kryesisht personel PAK.</p> <p>Institucioni nuk plotëson të gjitha kriteret e standartit III.3. Burimet njerëzore në këtë Institucion duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të tërhequr staf të kualifikuar.</p> <p>Institucioni nuk plotëson kriterin 1 të standartit III.4 për këtë program studimi. Institucioni duhet të punojë shumë në këtë drejtim pasi 79% të personelit PAE të angazhuar në këtë program studimi janë me titull Msc, e dhënë e marrë nga zyra e burimeve njerëzore dhe faqja e fakultetit. Kjo e pengon Institucionin në zhvillimin e tij afatmesëm dhe afatgjatë. Institucioni me këtë kualifikim stafi PAE që ka për këtë program studimi e ka të pamundur që të hapë program studimi të nivelit të dytë si Master Profesional ashtu dhe Master i Shkencave.</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Në shërbim të programeve të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike është vënë në dispozicion një ndërtesë e rikonstruktuar në të gjitha ambientet e saj, e përshtatshme për universitet me klasa dhe laboratorë. Klasa janë me hapësira dhe të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, tryeza pune komode. Laboratorët janë të pajisura me mjetet dhe aparaturat e nevojshme për kryerjen e punëve laboratorike të nevojshme për këtë program studimi.

Për këtë program studimi ashtu si dhe për programet e tjera të studimit që mbështet Departamenti i Inxhinierive ishte në dispozicion salla e internetit dhe biblioteka me orar të përcaktuar. Në fakultet ka ambiente për aktivitete promovuese si dhe nyje hidrosanitare.

Institucioni ka siguruar mjedise për dekanin dhe kancelaren e fakultetit si dhe zyra për përgjegjësin e Departamentit të Inxhinierive dhe personelin akademik.

B. Polu

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Nga vizita në Institucion konstatuam se ndryshe nga sa jepet në RVB, salla e bibliotekës dhe salla e internetit janë një, nuk ka laboratorë të veçantë për lëndën e elektroteknikës dhe të makinave elektrike, ato zhvillohen në të njëjtin ambient. Po kështu dhe laboratorët e elektronikës analoge dhe dixhitale zhvillohen në të njëjtin ambient, mbështetur në listën e laboratoreve dhe pajisjeve të vëna në dispozicion nga Institucioni. Këto ndryshime nuk ndikojnë në përmbushjen e standardeve për shkak të numrit të vogël të studentëve që ka në këtë stad ky program studimi.

Institucioni ka salla për të zhvilluar leksionet dhe seminarët për këtë program studimi, si dhe mjedise për stafin akademik dhe sekretarinë mësimore. Nuk ka zyrë informacioni për studentët. Informacionin studentët e marrin në sekretarinë mësimore.

Mjediset për Programin e studimit përbëhen nga:

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin përbëhen nga:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>K1. Nga vizita e bërë në bibliotekën e fakultetit pamë që ajo ishte në të njëjtin ambient me sallën e internetit. Literatura në shqip është e vjetëruar dhe numri i teksteve në gjuhë të huaj ishte i kufizuar.</p> <p>K2. Nga biseda me studentët na rezultoi që ato marrin më shumë leksione të printuara nga pedagogët. Duhet bërë përpjekje për pasurimin e mëtejshëm të bibliotekës me literaturë më bashkëkohore.</p> <p>K3. Gjatë vizitës në bibliotekë pamë që nuk kishte botime periodike por përdorej libraria elektronike Questia, e cila mendoj që nuk është libraria elektronike e duhur për këtë program studimi.</p> <p>K4. Nga bisedat e bëra mendojmë që përgjegjësit e</p>

Spalun

	<p>këtij programi studimi duhet të bëjnë përpjekje për pasurimin e literaturës në mbështetje të këtij programi studimi.</p> <p>K5. Biblioteka kishte të shpallura oraret e shërbimit që ishin të njëjta dhe për sallën e internetit, pasi ishin i njëjti ambjent.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhinieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>K1. Institucioni e plotëson këtë kriter pasi ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për realizimin e këtij programi studimi.</p> <p>K2. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>K3. Nga shqyrtimi i listës së pajisjeve të laboratorëve konstatojmë se laboratorët kanë aparaturat dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e laboratorëve të nevojshëm për këtë program studimi.</p> <p>K4. Institucioni e plotëson më së miri këtë kriter, pasi ka 7 laboratore.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Laboratori i informatikës 2. Laboratori i fizikës 3. Laboratori i kimisë 4. Laboratori i elektroteknikës dhe makinave elektrike 5. Laboratori i elektronikës analoge dhe digitale 6. Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike 7. Laboratori i automatikës dhe mekatronikës <p>K5. Në vizitën e bërë në institucioni konstatojmë se disponon kompjutera në sallën e internetit ku na u tha që ka dhe programe kompjuterike të dedikuara për këtë program studimi. kriter.</p> <p>K6. Institucioni nuk ka mjedise për zhvillimin e praktikave profesionale për këtë program studimi por ai ka nënshkruar disa marrëveshje me kompani të ndryshme për realizimin e praktikave mësimore.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p>	
<p>Institucioni duhet të bëjë përpjekje për pasurimin e bibliotekës me literaturë bashkëkohore dhe zgjerimin e mjedisit të saj, pasi si literature dhe mjedisi i vënë dispozicion na u dukën të pamjaftueshëm.</p> <p>Studentët merrnin leksione kryesisht të printuara nga pedagogët prandaj duhen bërë përpjekje për pajisjen me revista periodike si dhe në qendrën e botimeve që disponon Institucioni mund tu jepet përparësi botimeve për degët inxhinierike.</p> <p>Departamenti duhet të bëjë përpjekje për të përdorur një librari elektronike më të përshtatshme për këtë program studimi.</p> <p>Institucioni i plotëson kriteret e standartit V.2 pasi ka laboratorët e duhur dhe të pajisur me aparatura bashkëkohore për zhvillimin e laboratorëve në këtë program studimi.</p> <p>Institucioni nuk ka mundësi të zhvillojë praktika në ambjentet e tij. Për këtë qëllim Institucioni ka</p>	

nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme për zhvillimin e praktikave mësimore. Kohezgjatja e praktikës mësimore dy javë, siç zhvillohej për këtë program studimi është e pamjaftueshme, pasi kjo lëndë në programin mësimor është 4 kredite. Duhet të rritet kohëzgjatja e praktikës mësimore nga dy javë në katër javë, për tu përputhur me numrin e krediteve që ka lënda.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe aktivitete të tjera tregtare të përmendura RVB. Të gjitha të ardhurat nga tarifat e shkollimit shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese. Në rang universiteti ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare, dhe kontrollin e tyre të përmendura më poshtë tek kriteret.

Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor (për të gjitha vitet e kaluara) të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm. Në raport ka të dhëna të hollësishme për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative etj. Bazuar mbi kriteret e standardeve shtetërore të cilësisë ky Institucion ia ka dalë me sukses që të mbulojë me kosto financiare të gjitha shërbimet e kërkuara.

Kostot operative vjetore ndryshojnë nga njeri program studimi tek tjetri, për shkak të veçorive që ka secili prej tyre. Kështu në programe të tilla, si: Farmaci, Stomatologji, Arkitekturë, etj. kosto për student është më e lartë, krahasuar me programet e tjera sepse baza materiale e përdorur prej tyre dhe numri i vogël i studentëve në grupet mësimore është detyrues.

Burimet financiare janë ato që lidhen me tarifat e shkollimit të studentëve. Rreth 1/3 e këtyre burimeve të të ardhurave shpenzohet për qiranë e objektit dhe shërbime të tjera të lidhura me të (mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja etj.).

Pjesë tjetër e burimeve të të ardhurave shpenzohet për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin internet, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit.

Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR. Në këtë mënyrë treguesit për të ardhurat dhe financimet nuk janë të veçuara për çdo program studimi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Për këtë pjesë të raportit nuk kemi kërkuar dhe nuk na ofrua informacion në Institucion. Në axhendën e miratuar dhe të rënë dakort nuk ishte parashikuar vizitë në zyrën e financës të Universitetit. Kështu që në këtë pjesë gjithshka do të jetë e mbështetur në raportimin e bërë në RVB.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij; Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj; Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të	K1. Institucioni harton raportin e bilancit të të gjithë shoqërisë çdo vit në të cilin parashikohen të dhëna të hollësishme financiare për të ardhurat, mbështetur në RVB K2. Institucioni nuk na vuri ne dispozicion një raport audit por në RVB, f37, theksohet se Institucioni bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i

<p>lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>regjistruar për situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik.hoqërisë. Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet dhe të ardhurat.</p> <p>K3. Nga vizitat e bëra në institucion kemi konstatuar që nuk ka grante të huaja, sponsorizime, shërbime trainuese dhe kontrata shërbimesh të lidhura për të mbështetur këtë program studimi.</p>
<p>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</p>	
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>K1. Në vizitat e bëra në Institucion na u vu në dispozicion një material ku ishin të specifikuar tarifat e shkollimit që duhet të paguanin studentët për çdo program studimi, duke përfshirë dhe bachelor në Inxhinieri Elektrike.</p> <p>K2. Në RVB nuk ka deklarim për raportet financiare për vitin akademik 2013-2014, 2014 – 2015. Keshtu ne RVB ka informacion vetëm për vitin akademik 2012-2013. Mbështetur në tabelë 8 të RVB tregohet qartë se të ardhurat e siguruar për këtë program studimi janë vetëm nga tarifat e shkollimit të studentëve.</p> <p>K3. Nuk mund të gjykojmë për këtë kriter pasi nuk kemi informacionin e duhur.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p>	
<p>Në RVB duhet të ishte vënë informacion në lidhje me raportet financiare për dy vitet e fundit 2013-2014, 2014 – 2015 për të dhënë një vlerësim të saktë në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të Institucionit për këtë program studimi.</p> <p>Nga tabela 8 e RVB shihet qartë se Institucioni ka të ardhura të vetme ato nga tarifat e shkollimit. Institucioni nuk merr grante të huaja për kërkim, për konsulencë apo shërbime për të tretët, nuk ka sponsorizime për studentët apo për këtë program studimi, nuk kryen shërbime për të tretët, që ndikojnë në kualifikimin e vazhdueshëm të stafit.</p>	


6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Albanian University ka ngritur Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (ZSBC), në rang Universiteti, strukturë e cila harton politikat, metodologjinë që do të përdoret, dhe mënyrën e përpunimit dhe publikimit të rezultateve. ZSBC i vihen në dispozicion nga sekretaria mësimore, të dhëna statistikore, të mbledhura gjatë anketimeve të studentëve, raporteve semestrale të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të departamenteve, si dhe rezultateve të arritura nga studentët.

ZSBC është në varësi të drejtpërdrejtë të Rektorit të Universitetit, dhe ka detyrimin e paraqitjes së një raporti vjetor në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrevë të cilësisë. Ky raport i paraqitet Rektorit, i cili më tej e përfshin atë në rendin e ditës së Senatit Akademik për diskutim. Duke u përqendruar kështu jo vetëm në një kontroll të vazhdueshëm për sigurimin e cilësisë, por duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të këtij sistemi për të arritur rezultate maksimale në misionin e Universitetit, që është mësimdhënia.

Funksionet dhe detyrat e ZSBC, janë të parashikuara shprehimisht në nenin 13 të Rregullores së brendshme të Universitetit. Në mbështetje të Statutit, Rregullores, ligjeve dhe akteve nënligjore



në fuqi, kjo zyrë ushtron funksion mbështetës, këshillimor, bashkërendues, monitorues dhe administrativë me strukturat e tjera akademike dhe administrative të Universitetit, si dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.

ZSBC dhe zyra e kurrikulave është e përbërë nga një grup pune prej tre individësh e përkatësish: Elona Mehmeti, Sidita Çoniku dhe Leudita Docaj. Kjo zyrë harton politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton dhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën të mundur hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese, të cilat me tej ju shpërndahen Departamenteve dhe pas plotësimit të tyre prej studentëve ose pedagogëve, ZSBC bën përpunimin e të dhënave dhe nxjerr problematikat kryesore, përmirësimet që duhen kryer me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, intervenimeve të të gjithë faktorëve përbërës së Universitetit.

Duhet theksuar se ZSBC, ka gjithashtu detyrimin e publikimit të të dhënave të nxjerra nga raportet vjetore, publikimi i këtyre të dhënave duhet miratuar nga instanca më të larta hierarkike dhe deri tani publikimet mungojnë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Nga vizitat në institucion konstatuam se në ndryshim me atë të deklaruar në RVB zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe e kurrikulave është vetëm në nivel Universiteti dhe jo në nivel Departamenti. Kontrollin dhe vlerësimin kjo zyrë e realizonte në bazë të të dhënave statistikore, të mbledhura gjatë anketimeve të studentëve, raporteve semestrale të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të departamenteve, si dhe rezultateve të arritura nga studentët. Të gjitha këto të dhëna statistikore vihen në dispozicion ZSBC nga sekretaria mësimore. Nuk bëjmë dot vlerësim nëse ka ndryshime në programet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara, pasi nuk kemi patur të vëna në dispozicion programet mësimore kur është licensuar ky program studimi. Nga bisedat e bëra në Institucion na u deklarua që nuk ka ndryshime në programet mësimore të lëndëve për këtë program studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara 	<p>K1. Institucioni përdor formular vlerësimi të plotësuar nga studentët dhe pedagogët në fund të semestrit për të vlerësuar ecurinë e programit të studimit.</p> <p>K2. Informacionin e vlerësimit e kemi parë të përfshirë në raportin e përgatitur nga përgjegjësi i departamentit të Inxhinierive në fund të semestrit të parë për vitin akademik 2015-2016.</p> <p>K3. Institucioni nuk ka publikuar rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë. Në vizitën që patëm në zyrën e sigurimit të brendshëm të cilësisë nuk na u dha një përgjigje e saktë se si vazhdohej procedura mbas marrjes së këtyre vlerësimeve, nëse kishte rezultate që ishin nën nivelin e pritshmërisë së kërkuar.</p> <p>K4. Institucioni përdor metoda të tërthorta si:</p>

<p>kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Vlerësimi me nota/pikë;</p> <p>d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</p> <p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	<p>a. Pyetësor të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</p> <p>b. Raport semestral i personelit akademik për të vlerësimin të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</p> <p>Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta për kryerjen e vlerësimit</p> <p>a. Vlerësimi me nota/pikë;</p> <p>b. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</p> <p>c. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>d. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p>
---	---

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

K1. Institucioni Albanian University është në proces organizimi institucional.

K2. Institucioni përdor zyrën e sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe raportet e përgatitura nga përgjegjësi i departamentit për të analizuar cilësinë e mësimdhënies për këtë program studimi.

K3. Institucioni nëpërmjet formularit të vlerësimit për studentët dhe pedagogëve ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programit të studimit.

K4. Mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit janë të paraqitura në rregulloren e programit të studimit.

K5. ZBSC dhe përgjegjësi i Departamentit në raportin e tij semestral synojnë vënien në dukje të problematikës dhe ndërgjegjësimin e stafit dhe studentëve mbi cilësinë e programit të studimit.

K6. Strategjia, politikat dhe procedurat për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë nuk janë të publikuara as si material i printuar as në site e Universitetit.

Konkluzione të GVJ:

ZBSC dhe përgjegjësi i departamentit përgatisin raporte semestrale mbështetur në formularët e vlerësimit për studentët dhe personelin akademik, ku evidentohet problematika e shfaqur në mësimdhënie dhe vështërsitë e hasura në realizimin e një mësimdhënie cilësore. Por kjo nuk vazhdohej më tej mbetej vetëm në konstatime.

Institucioni nuk plotëson kriterin 3 të standartit II.3 pasi nuk publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë, të cilat nuk i gjetëm të publikuara as nga vizita në Institucion dhe as në site e Institucionit.

Institucioni duhet të bëjë më shumë përpjekje për ti bërë publike rezultatet e vlerësimit pasi këto janë një shtysë e rëndësishme në ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programin e studimit.

Rregullorja e programit të studimit në Inxhinieri Elektrike, e paraqitur në dosje duhet të plotësohet me Nr. e Vendimit të Senatit Akademik dhe datën e tij, të cilët tregojnë miratimin e saj.

Në vizitën në Institucion nuk na paraqitën një dokument të publikuar në lidhje me strategjinë, politikat dhe procedurat për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Nuk gjetëm asnjë dokument në lidhje me strategjinë, politikat dhe procedurat për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të publikuar në site e Universitetit.

ZSBC duhet që raportet e përgatitura, të cilat kanë marrë dhe aprovimin e autoriteteve përkatëse, ti bëj publike si dhe duhet të merren masa për të përmirësuar cilësinë në mënyrë të vazhdueshme.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkimore

Programi i studimit në Inxhinieri Elektrike ka për qëllim të hedhë bazat shkencore dhe përgatitjen teorike-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si inxhinier në fushën e sistemeve elektrike të fuqisë, të automatizimit të industrisë si dhe në sektorë të tjerë ku përdoret energjia elektrike.

Kjo përgatitje e përgjithshme gjatë periudhës trevjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfutur kompetenca më specifike mbi tema më të profilizuara që mund të trajtohen gjatë studimeve të specializuara. Gjithashtu, programi, ka për qëllim t'i përgatisë studentët si specialistë për të punuar në sektorë të tjerë të ngjashëm inxhinierikë.

Programi i studimit ka për qëllim të krijojë një profil të mirë të studentit të diplomuar, i cili do të jetë i aftë që nëpërmjet procesit të përfitimit të njohurive dhe vlerësimit, të zhvillojë një sërë shprehish dhe kompetencash, si:

- a) aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë në institucione e firma të ndryshme ku ka sisteme elektrike të fuqisë, të industrisë dhe të automatikës, etj.,
 - b) aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë drejtpërdrejtë në industrinë e prodhimit të pajisjeve elektrike apo të projektimit dhe realizimit të tyre,
 - c) pas një periudhe stazhi në profesion, aftësinë për të drejtuar kualifikimin apo edhe përgatitjen e teknikëve dhe kuadrove të ardhshëm në këto fusha.
1. Disiplinat e formimit të përgjithshëm plotësojnë 44 ETCS ose 24.5 % të programit të përgjithshëm.
 2. Disiplina të formimit karakterizues plotësojnë 83 ETCS ose 46.1% të programit formues.
 3. Disiplinat formuese të ngjashme ose integruese me disiplinat karakterizuese plotësojnë 15 ETCS ose 8.3 % të programit formues.
 4. Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët plotësojnë 10 ECTS ose 5.6 % të programit.
 5. Disiplinat e veprimtarisë formuese për gjuhë, informatikë dhe praktika plotësojnë 22 ETCS ose 12.2 % të programit të formimit.
 6. Provimi i diplomës plotëson 6 ETCS ose 3.3 % të strukturës Bachelor.

Kreditet mundet të fitohen, të sigurohen, të akumulohen ose të transferohen, nga studenti. Kreditet e një lënde fitohen, kur vlerësimi në atë lëndë është kalues. Nga brenda Universitetit

janë të transferueshme të gjitha kreditet e fituara. Llogaritja e krediteve bëhet sipas koeficienteve orientues të miratuar nga MAS.

Kreditet e një lënde sigurohen kur studenti ka plotësuar kushtet e frekuentimit, ka shlyer detyrimet e laboratorëve dhe detyrave të kursit dhe është vlerësuar kalues në provimit të dhënë të lëndës.

Një vit akademik konsiderohet i kryer kur studenti ka fituar jo më pak se 60 kredite. Për përfundimin e studimeve të Ciklit të Parë studentit i duhet të fitojë minimalisht 180 kredite. Afati maksimal i përfundimit të studimeve të plota është gjashtë vite akademike. Afati maksimal i provimit të diplomës është deri në tre vite nga përfundimi i studimeve të plota.

Kontrolli i dijeve bëhet një kontroll gjatë gjithë kohës së zhvillimit të lëndës dhe jo në fund të lëndës. Kështu pjesmarrja aktive gjatë mësimit 10 pikë në 100, rezultatet e arritura në laborator 10 pikë në 100 gjithsej, dhe detyra apo projekti i kursit 5 pike ne 100 gjithsej, provimi i ndërmjetëm 15 pike në 100 gjithsej. Kështu studenti hynte në provim me maksimumi 40 pike dhe 60 pike ishte maksimumi i pikeve per provimin perfundimtar. Sudenti quhet kaluaes me 41 pikë e sipër.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

➤ 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor

➤ 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit është si më poshtë:

- | | | |
|------------------------------|-----------------------|-----------------------------------|
| ▪ Për leksionet | 12 orë në auditor dhe | 13 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret | 15 orë në auditor dhe | 10 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Laboratorët | 15 orë në auditor dhe | 10 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikat lëndore | 0 orë në auditor dhe | 0 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 0 orë në auditor dhe | 25 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Provimi përfundimtar | 0 orë në auditor dhe | 25 orë punë e pavarur e studentit |

Mbështetur në informacionin e marrë gjatë vizitës në Fakultet nuk ka ndryshime me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues (Tabela 5 në RVB).

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës jepen në Aneksin 5

Nga shqyrtimi i programeve mësimore të lëndëve për programin e studimit bachelor, konstatojmë se mungojnë plotësisht syllabusët e lëndëve për semestrin e dytë të vitit të tretë, mbështetur në të dhënat e vendosura në faqen e APAAL. Për lëndën e Materialeve Elektroteknike literatura e detyruar nuk përshtatet me këtë lëndë. Në lëndët Makina Elektrike 1 dhe Makina Elektrike 2 orët e vëna në dispozicion janë të pamjaftueshme për realizimin e laboratoreve. Për lëndën Sistemet Elektrike të Fuqisë mendoj se titullari i lëndës nuk përputhet me këtë lëndë dhe programi i lëndës është i ngarkuar dhe i vështirë për tu asimiluar nga studentët me numrin e krediteve që ka lënda, 5 kredite. Për lëndën Gjuhën e Huaj duhet të ishte vënë literaturë libri i gjuhës së huaj angleze për Inxhinierin

Elektrike, në mënyrë që studentët të mësohen me terminologjinë që do të hasin në literaturën në gjuhë të huaj, gjatë studimit në këtë program studimi. Titullari i lëndës Arkitektura e Sistemeve të Kontrollit mendoj që nuk përputhet me këtë lëndë. Laboratorët për lëndën "Prodhimi, shpërndarja dhe përdorimi i energjisë elektrike 1" nuk përputhen me pjesën teorike dhe ushtrimet për këtë lëndë.

Në rregulloren e studimit për programin Bachelor në Inxhinieri Elektrike, neni 27, plka f) tregohet që studenti kalon sikur të marrë dhe vetëm një pikë në provimin përfundimtar të lëndës. Ky nuk më duket një vlerësim i drejtë për të marrë notën kaluese. Me duket i drejtë vlerësimi gjatë gjithë vitit por nuk mundet pjesëmarrja gjatë vitit, laboratorët dhe provimi i ndërmjetëm të jenë përcaktues. I rekomandoj të rishikojnë këtë vlerësim dhënë në nenin 27.

Syllabus-et e paraqitura në këtë program studimi kanë elementët e mëposhtëm:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>K1. Institucioni ofron programe të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>K2. Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>K1. Nga takimi me studentët konstatuam se ato merrnin informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimit nga sekretaria mësimore.</p> <p>K2. Sekretaria mësimore e Fakultetit jepte informacionin e nevojshëm për lëndët e detyruara apo me zgjedhje për semestër.</p> <p>K3. Informacion të plotë studentët merrnin në sekretarinë mësimore.</p> <p>K4. Në faqen e Institucionit për Fakultetin e Inxhinierive jepet vetëm kurrikula me listën e lëndëve për programin e studimit bachelor ne Inxhinieri Elektrike. Do ti sugjeronim Institucionit që në site e fakultetit të vendosen të paktën lëndët shkurtimisht, me ndarjen në kredite dhe orët</p>

Spolu

përkatëse për leksionet, ushtrimet, laboratorët.

Konkluzionet e GVJ:

Institucioni plotëson Standartin I.1 pasi programi është i organizuar me module dhe i vlerësuar me kredite dhe sasia mesatare e krediteve për një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite.

Institucioni duhet të përmirësojë më tej informimin për këtë program studimi. Informim, i cili nuk duhet realizuar vetëm nëpërmjet sekretarisë mësimore por dhe nëpërmjet informacionit më të detajuar në faqen e Institucionit. Ky informacion do të ndihmonte shumë në orientimin e studentëve dhe në marrjen e informacionit të plotë në lidhje me këtë program studimi.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Procesi mësimor është i organizuar në vite akademike. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe 6 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Studenti zhvillon deri në 25 orë mësimore në auditor/javë. Në 25 orë përcaktuese të një krediti përfshihen, përveç orëve mësimore në auditor, dhe koha për punë të pavarur të studentit.

Koha e fillimit, mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik të miratuar nga Senati, statuti i Institucionit. Gjatë vitit të parë akademik organizohen tre sesione provimesh. Në vitet e tjera akademike organizohen pesë sesione provimesh të përcaktuara në kalendarin akademik të çdo programi mësimor dhe tre sesione diplomimi. Me vendim të Senatit Fakultetet kanë të drejtë të organizojnë edhe sesione të tjera të kufizuara të provimeve të bartura (riprovime), jashtë kalendarit akademik, para përfundimit të semestrit të parë dhe semestrit të dytë. Në këto provime studentët paraqiten kundrejt pagesës përkatëse.

Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyrat ose projekte kurse, praktika profesionale. Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje. Lëndët e këtij programi studimi janë të gjitha lëndë semestrale. Lëndët zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur, të ndërtuar mbi kritere pedagogjike me qëllim shpërndarjen e ngarkesës mësimore në mënyrë të balancuar.

Nga bisedat me studentë dhe personel akademik konstatoam se metodat kryesore të mësimdhënies ishin nëpërmjet slideve, shkrimit në tabelë, mësimdhënie e kombinuar nëpërmjet diskutimeve pedagog studentë etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Në RVB vihet në dukje se numri total i veprimtarive formuese është 22, ku janë parashikuar 20 provime, 1 praktikë dhe 1 provim i diplomës. Nga vizita në Departament dhe nga bisedat me studentët dhe anëtarët e grupit të vlerësimit të brendshëm konstatoam se në fakt numri i veprimtarive formuese është 38, ku janë parashikuar 36 provime, 1 praktikë mësimore dhe 1 provim i temës së diplomës, tabela 13 në RVB dhe tabela 5 në anksin e këtij raporti. Më tej bëhet përmendimi i këtyre veprimtarive formuese për të marrë 22 veprimtari në përputhje me udhëzimin Nr. 15, datë 04/04/2008, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Institucioni ka model të diplomës suplement për programet e tjera të studimit por nuk ka diplomë suplement për këtë program studimi, megjithëse janë diplomuar studentët e parë.

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet janë:

- Leksione

- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Praktikë profesionale

- Format e kontrollit të njohurive. Në këtë program studimi bëhet një kontroll gjatë gjithë kohës së zhvillimit të lëndës dhe jo në fund të lëndës. Kështu pjesmarrja aktive gjatë mësimit vlerësohet me 5 pikë në 100, rezultatet e arritura në laborator vlerësohen me 5 pikë në 100 gjithsej, dhe detyra apo projekti i kursit vlerësohet me 10 pikë në 100 gjithsej, provimi i ndërmjetëm vlerësohet me 20 pikë në 100 gjithsej. Keshtu studenti hynte në provim me maksimumi 40 pikë dhe 60 pikë ishte maksimumi i pikeve për provimin përfundimtar. Sudenti quhet kalues me 41 pikë e sipër.
- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj. Studentët janë aktivizuar në një konferencë studentore.

9. Studentët

Pjesa përshkimore

Nga vizita e bërë në sekretarinë mësimore të fakultetit dhe shqyrtimi i dokumentave në mënyrë rastësore për studentët dokumentat e pranimit të studentëve ishin:

- a. Diplomë e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave.
- b. Dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011).
- c. Fotokopje e kartës së identitetit, letër njoftimit ose pasaportës.
- d. Fotografi
- e. Formulari i aplikimit
- f. Kontrata me Institucionin në lidhje me tarifën e shkollimit
- g. Fatura e pagesës së bërë për tu regjistruar.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar, gjatë vizitës në Institucion sekretaria mësimore kishte informacion të plotë në lidhje me numrin e studentëve në hyrjen dhe në dalje, kohëzgjatja mesatare e studimeve është 3 vite. Mbështetur në raportin për semestrin e parë të vitit akademik 2015-2016 të përgjegjësit të Departamentit të Inxhinierive kalueshmëria e studentëve për programin e studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike, filiali i Tiranës ka qënë: viti parë 59%, viti i dytë 29%, viti i tretë 33%. Në këtë raport jepet një analizë e hollësishme e arsyeve të kësaj kalueshmërie.

Orientimi i punësimeve të sapo diplomuarëve dhe informimi i tyre realizohej nga zyra e karrierës e cila kishte përgatitur në vitin 2016 dhe një "Udhëzues për zhvillimin e Karrierës". Zyra e karrierës ndihmonte dhe organizonte dhe Konferencën studentore.

Nga vizita e bërë në Institucion vumë re që nuk kryhej asnjë aktivitet nga zyra e karrierës, siç mund të jenë ditët e karrierës për nxënësit e shkollave të mesme, për të promovuar këtë program studimi në mënyrë që të rritet cilësia e studentëve në hyrje. Kjo është shumë e nevojshme për këtë program studimi pasi cilësia në hyrje për këtë program studimi është e ulët.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Nga vizita në Institucion nuk u vunë re ndryshime nga deklaratimet e bëra në RVB. Numri i studentëve të diplomuar për herë të parë është 6 me një notë mesatare 6.4 por nuk ka një informacion nëse ato ishin të punësuar në përputhje me diplomën apo jo.

Nuk ka procedura të veçanta për pranimin e studentëve për këtë program studimi. Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve është e ulët. Studentë të regjistruar për herë të parë në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, në Tiranë, për vitin akademik 2015-2016 janë 36 studentë. Nuk ka mobilitet të studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>K1. Pranimi në këtë program studimi bëhet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore.</p> <p>K2. Institucioni i Arsimit të Lartë nuk propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>K1. Studentët informohen nga sekretaria mësimore për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>K2. Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit me anë të plotësimit të formularit të vlerësimit.</p> <p>K3. Zyra e karrierës u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës.</p> <p>K4. Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>
Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>K1. Institucioni disponon statistika për këtë program studimi.</p> <p>K2. Nga vizita e bërë në sekretarinë mësimore konstatuam se Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit.</p> <p>K3. Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim. Këto të dhëna i dispononte sekretaria mësimore e Fakultetit.</p>
Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>K1. Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve nëpërmjet zyrës së karrierës, për këtë duhej studentët të shkonin të interesoheshin. Mendoj që zyra e karrierës vetëm me një person për të gjithë Institucionin është e pamjaftueshme për të patur një orientim të plotë të studentëve.</p> <p>K2. Orientimi për praktikën mësimore në këtë</p>

program studimi realizohej nga departamenti i Inxhinierive dhe jo nga zyra e karrierës. Procesi i zhvillimit të praktikave mësimore ka nevojë për instucionalizim të mëtejshëm.

Konkluzionet e GVJ

Institucioni plotëson kriterin 1 të standartit IV.1 por duhet të bëjë përpjekje për të rritur cilësinë e studentëve në hyrje duke vënë kritere të tjera përzgjedhëse, pasi nota mesatare e tyre është e ulët për një program studimi të tillë. Kjo reflektohet qartë në kalueshmërinë e tyre dhe rezultatet e arritura për semestrin e parë të vitit akademik 2015-2016.

Institucioni duhet të jetë aktiv dhe në zhvillimin e ditëve të karrierës për nxënësit e shkollave të mesme për të rritur cilësinë e studentëve në hyrje. Aktivitet ky që nuk kryhej nga zyra e karrierës në këtë Institucion.

Institucioni informon studentët në lidhje me mundësitë e punësimit nëpërmejt zyrës së karrierës dhe disponon statistika në lidhje me studentët që ndjekin këtë program studimi.

Zyra e karrierës vetëm me një person për të gjithë Institucionin e ka të vështirë të bëjë një orientim të plotë të tyre.

Institucioni duhet të sigurojë instucionalizim më të mirë të praktikave mësimore, për të plotësuar plotësisht kriterin 2 të standartit IV.4.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Institucioni për të mbështetur botimet akademike dhe kërkimin shkencor ka krijuar njësinë e botimeve akademike dhe revistën shkencore "OPTIME". Nga lista e botimeve akademike nga kjo njësi, të vëna në dispozicion rezulton se për këtë program studimi numri i librave të botuara, që lidhen me këtë program studimi, është për lëndët e matematikës së viti të parë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Gjatë vizitës në Institucion konstatoam se Departamenti i Inxhinierive nuk është i përfshirë në projekte kërkimore brenda apo jashtë vendit, nuk ka asnjë projekt kërkimor të zbatuar. Studentët e këtij programi studimi nuk janë të përfshirë në kërkimin shkencor. Tabela e mëposhtme jep aktivitetet për kërkimin shkencor në rang Institucioni, RVB, tabela 21.

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang Institucioni në pesë vitet e fundit		
1	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	36
2	Numri i projekteve kërkimore të fituara	0
3	Numri i projekteve të zbatuara	45
4	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL	3
5	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL	16
6	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	44
7	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	7
8	Numri i Çmimeve Kombëtare	1

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Departamenti i Inxhinierive dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ashtu sic konstatohet dhe në RVB, faqe 65, nuk ka bashkëpunime me Institucione partnere brenda dhe jashtë vendit dhe nuk është i përfshirë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Nuk ka mobilitet të studentëve nga dhe drejt IAL si dhe nuk ka patur lektorë të huaj për këtë program studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>K1. Institucioni nëpërmjet revistës shkencore "OPTIME" nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit si dhe në punën e tyre kërkimore.</p> <p>K2. Institucioni nëpërmjet analizës së punës semestrale të departamentit dhe fakultetit bën vlerësimin e plotësimin të detyrave të vëna.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>K1. Institucioni nuk ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit. Si marrëdhënie bashkëpunimi e vendosur, për këtë program studimi, është punësimi i personelit akademik me kontratë PAK, me grada dhe tituj të institucionit publik të arsimit të lartë, Universiteti Politeknik të Tiranës.</p> <p>K2. Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës për këtë program studimi.</p> <p>K3. Institucioni nuk organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit.</p> <p>K4. Institucioni nuk zotëron një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale për realizimin e praktikës mësimore.</p>
Konkluzionet e GVJ.	
<p>Universiteti bën përpjekje për nxitjen e bashkëpunimit dhe punës shkencore midis personelit të vet në plotësimin e standartit VII.1</p> <p>Institucioni ka vështërsi në plotësimin e standartit VII.2 pasi nuk rezultoi të ketë marrëveshje bashkëpunimi dhe të jetë përfshirë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare me institucione homologe jashtë vendit dhe bashkëpunimi brenda vendit është në nivel të ulët, për programin e studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike.</p> <p>Institucioni ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme për kryerjen e praktikave mësimore për këtë program studimi por nuk organizon trajnime të mëtejshme profesionale në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	

Institucioni nuk zotëron një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale për realizimin e praktikës mësimore.



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

RVJ mbyllet me “**Analizën përmbledhëse të RVJ**” sipas metodës **SWOT** (**Strengths**-pikat e forta, **Weaknesses**- pikat e dobëta, **Opportunities**-Mundësitë, **Threats**-pengesat).

a. Pika të forta:

- 1) Institucioni ka infrastrukturën dhe laboratorët e duhur për zhvillimin e procesit mësimor për këtë program studimi.
- 2) Programi i studimit bachelor në Inxhinieri Elektrike është i hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Institucionit dhe ruan vlerat kulturore kombëtare.
- 3) Institucioni ka statistika të plota mbi studentët, të cilët ndjekin këtë program studimi dhe bën përpjekje në vlerësimin e ecurisë së tyre.
- 4) Institucioni ka njësinë botuese si dhe revistën shkencore “Optime”

b. Pika të dobëta:

- 1) Personeli akademik efektiv, i punësuar me kohë të plotë për këtë program studimi është më pak se 50% dhe 79% e tyre zotëron diplomë master.
- 2) Cilësia e ulët e studentëve të pranuar në këtë program studimi.
- 3) Mungesa e bashkëpunimit me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.
- 4) Mungesa e pjesmarrjes si partnerë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare
- 5) Mungesa e mobilitetit të studentëve kundrejt IAL-ve brenda dhe jashtë vendit.
- 6) Mungesa e trainimeve profesionale.

c. Mundësitë:

- 1) Krijimi i kushteve për tërheqje të personelit akademik më të kualifikuar dhe mbështetje për kualifikimin sa më të shpejtë të stafit aktual.
- 2) Pasurimi i bibliotekës së fakultetit me literaturë bashkëkohore.
- 3) Rritja e informimit mbi programin e studimit për të rritur cilësinë e studentëve që ndjekin këtë program studimi.
- 4) Krijimi i kushteve për bashkëpunim me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.
- 5) Institucionalizimi i marrëveshjeve me kompani të ndryshme.

d. Pengesat:

- 1) Vështësi në kualifikimin e mëtejshëm profesional për personelin akademik efektiv.
- 2) Mungesa e një studimi tregu për këtë program studimi.
- 3) Kualifikimi i ulët i personelit akademik efektiv zvogëlon mundësinë për realizimin e objektivave afatmesme dhe afatgjata, hapjen e programeve të ciklit të dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike. Kjo do të ulë interesin e studentëve cilësor për ndjekjen e këtij programi studimi.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. Asc. Dr. Aida Spahiu

ANEKSI 1

Tabela 1: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike	Departamenti i Inxhinierive, 2015-2016					
	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
	0	Prof. Dr.	3	Prof. Dr.	3	Prof. Dr.
2	Prof. Asoc. Dr.	9	Prof. Asoc. Dr.	11	Prof. Asoc. Dr.	
2	Dr.	13	Dr.	15	Dr.	
15	Msc.	2	Msc	17	Msc	

ANEKSI 2

Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakulteti i Shkencave të aplikuara dhe Departamenti i Inxhinierive						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time	
1 Setki Mulla	Përgjegjës Departamenti	Prof.Asoc.	1 Ada Gogu	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës	
2 Luigj Gjoka	Pedagog	Prof.Asoc.	2 Agim Anxhaku	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan	
3 Almarin Frakulli	Pedagog	MSc.	3 Alban Rakipi	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës	
4 Arber Vila	Pedagog	MSc.	4 Ariana Bejleri	Prof. Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës	
5 Armela Mazreku	Pedagoge	MSc.	5 Bexhet Kamo	Prof. Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës	
6 Besmir Kanushi	Pedagog	MSc.	6 Desari Shahu	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës	
7 Burhan Çanga	Pedagog	MSc.	7 Dhurata Kuqi	Prof. Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës	
8 Eglantina Merkaç	Pedagoge	MSc.	8 Eduard Serdari	MSc.	Universiteti "Ismail Qemali" Vlore	
9 Ermira Vito	Pedagoge	MSc.	9 Enkela Nocka	Prof. Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës	
10 Fatmir Basholli	Pedagog	Dr.	10 Evjola Spaho	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës	
11 Ilir Çela	Pedagog	MSc.	11 Evis Plaku	MSc.	Bashkia Berat	
12 Katerina Dhoska	Pedagoge	MSc.	12 Fatmir Brati	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës	
13 Lek Pepkolaj	Pedagog	Dr.	13 Genta Rexha	Dr.	Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan	
14 Meri Mata	Pedagoge	MSc.	14 Iglj Tafa	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës	

15	Neralda Berberi	Pedagoge	MSc.	15	Illir Shinko	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
16	Pranvera Hysenaj	Pedagoge	MSc.	16	Ilo Bodi	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
17	Robert Kodra	Pedagog	MSc.	17	Indrit Enesi	Prof. Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
18	Sidita Çoniku	Pedagoge	MSc.	18	Klodian Gumeni	Dr.	KESH
19	Vasilika Papa	Pedagoge	MSc.	19	Luçiana Toti	Dr.	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
				20	Luela Prifti	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
				21	Nako Hobdari	Prof.Dr.	Pension
				22	Petraç Marango	Prof. Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
				23	Renalda Kushe	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
				24	Romeo Teneqexhi	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
				25	Sanie Çela	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
				26	Viktor Topulli	Prof. Asoc.Dr.	Pension
				27	Ymer Luga	Prof. Dr.	Pension

ANEKSI 3

Tabela 3: Të dhënat e stafit akademik sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Titulli	Departamenti i Inxhinierive Viti akademik 2015 - 2016		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	0	3	0/3
Profesorë të As.	2	9	2/9
Doktorë	2	13	2/13
Docentë	0	0	0/0
Pedagogë (pa tituj)	0	0	0/0
Asistentë me Ma	15	2	15/2
Asistentë pa Ma	0	0	0/0

ANEKSI 4

Tabela 4: Të dhëna për anëtarët e NJSBC

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Elona Mehmeti	Drejtuese	5vite
2	Sidita Çoniku	Anëtare	1 vit
3	Leudita Docaj	Anëtare	3 vite

Spolu

ANEKSI 5

Tabela 6: Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Lënda /Moduli		Pedagogu/ët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK
1.	Fizika 1	Dhurata Kuqi	Prof.Asoc.Dr.		PAK
		Eglantina Merkaçaj	MSc.		PAE
2.	Analizë matematike 1	Setki Mulla	Prof.Asoc.Dr.		PAE
3.	Algjebër – Gjeometri	Setki Mulla	Prof.Asoc.Dr.		PAE
		Sildona Ristani	MSc.		PAK
		Lekë Pepkolaj	Dr.		PAE
4	Kimi	Enkela Noçka	Prof.Asoc.Dr.		PAK
		Armela Mazreku	MSc.		PAE
5	Elementë bazë të informatikës	Ariana Bejleri	Prof.Asoc.Dr.		PAK
		Albana Gorishti	Dr.		PAK
		Besmir Kanushi	MSc.		PAE
6	Gjuhë e huaj (sem.1)	Erida Skufi	MSc.		PAK
		Vaslika Papa	MSc.		PAE
7	Fizika 2	Dhurata Kuqi	Prof.Asoc.Dr.		PAK
		Eglantina Merkaçaj	MSc.		PAE
8	Gjuhë e huaj (sem.2)	Erida Skufi	MSc.		PAE
9	Analizë matematike 2	Setki Mulla	Prof.Asoc.Dr.		PAE
		Sildona Ristani	MSc.		PAE
10	Probabilitet e statistikë	Setki Mulla	Prof.Asoc.Dr.		PAE
		Sildona Ristani	MSc.		PAE
11	Elektroteknika 1	Fatmir Basholli	Dr.		PAE
		Burhan Çanga	MSc.		PAE
12	Hyrje në eksperimentim laboratorik	Arbër Vila	MSc.		PAE
13	Teknikë dhe gjuhë programimi	Ariana Bejleri	Prof.Asoc.Dr.		PAK
		Sildona Ristani	MSc.		PAE
14	Matje elektrike dhe elektronike 1	Viktor Topulli	Prof.Asoc.Dr.		PAK
		Agron Laçi	MSc.		PAK
		Burhan Çanga	MSc.		PAE
15	Analizë komplekse	Luigi Gjoka	Prof.Asoc.Dr.		PAE
16	Elektroteknika 2	Romeo Teneqexhi	Dr.		PAK
		Fatbardha Bilali	MSc.		PAK
		Katerina Dhoska	MSc.		PAE
17	Makina elektrike 1	Ymer Luga	Prof.Dr.		PAK
		Burhan Çanga	MSc.		PAE
18	Mekanika e aplikuar në makina	Agim Anxhaku	Prof.Asoc.Dr.		PAK
19	Bazat e elektronikës	Sanie Çela	Dr.		PAK

		Arbër Vila	MSc.		PAE
		Robert Kodra	MSc.		PAE
20	Matje elektrike dhe elektronike 2	Viktor Topulli	Prof.Asoc.Dr.		PAK
		Agron Laçi	MSc.		PAK
		Burhan Çanga	MSc.		PAE
21	Analizë numerike	Daniela Qendraj	MSc.		PAE
		Sildona Ristani	MSc.		PAE
22	Fizika teknike	Agim Anxhaku	Prof.Asoc.Dr.		PAK
		Eglantina Merkaç	MSc.		PAE
23	Teoria e fushës elektromagnetike	Desar Shahu	Dr.		PAK
		Eglantina Merkaç	MSc.		PAE
24	Lëndë me zgjedhje (Gr.1) CAD (Vizatimi me ndihmën e kompjuterit)	Klodian Gumeni	Dr.		PAK
		Sidita Çoniku	MSc.		PAE
25	Makina elektrike 2	Ymer Luga	Prof.Dr.		PAK
		Burhan Çanga	MSc.		PAE
26	Elektronika e fuqisë	Andi Kallushi	MSc.		PAE
		Burhan Çanga	MSc.		PAE
27	Prodhimi, shpërndarja, përdorimi i energjisë elektrike 1	Fatmir Brati	Dr.		PAK
28	Bazat e automatikës 1	Petraç Marango	Prof.Dr.		PAK
		Ermal Elbasani	MSc.		PAK
		Ilber Puci	MSc.		PAK
		Arbër Vila	MSc.		PAE
29	Teknikë sigurimi	Nako Hobdari	Prof.Dr.		PAK
		Fatmir Basholli	Dr.		PAE
30	Arkitektura e sistemeve të kontrollit	Alban Rakipi	MSc.		PAK
31	Ekonomia e ndërmarrjeve elektrike	Almarin Frakulli	MSc.		PAE
		Mimoza Zeneli	MSc.		PAK
		Ermira Vito	MSc.		PAE
32	Lëndë me zgjedhje (Gr.2) Ndriçimi elektrik	Andi Kallushi	MSc.		PAE
		Pranvera Hysenaj	MSc.		PAE
33	Bazat e automatikës 2	Petraç Marango	Prof.Dr.		PAK
		Arbër Vila	MSc.		PAE
34	Transmisione elektrike	Andi Kallushi	MSc.		PAE
		Burhan Çanga	MSc.		PAE
35	Prodhimi, shpërndarja, përdorimi i energjisë elektrike 2	Fatmir Brati	Dr.		PAK
		Andi Kallushi	MSc.		PAE
36	Cilësia, normativa, legjislacioni teknik	Orion Zavalani	Prof.Asoc.Dr.		PAK

Spolu